

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

FINCA KOSOVË

31 DHJETOR 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e pozitës financiare	3
Pasqyra e tepricës ose deficitit dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënime mbi pasqyrat financiare	7-38

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUAR

Për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e FINCA Kosovë

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të FINCA Kosovë ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e suficitit ose deficitit dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e gjendjes së fondeve dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon në këtë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë politikat materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese të Organizatës janë përgaditur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me nenin 102, të Ligjit Nr. 04 / L-093, të datës 11 Maj 2012, "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare", siç është përshkruar në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, dhe rregullave e rregulloreve të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontablistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontablistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje Tjetër


Pasqyrat financiare të Finca Kosovë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023, janë audituar nga një auditor tjetër që ka lëshuar një opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra më 29 mars 2024.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me nenin 102, të Ligjit Nr. 04 / L-093 "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare" siç detajohet në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING



Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave individuale financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Bankës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat individuale financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Organizatatë ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave individuale financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat individuale financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.
RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

28 Prill 2025


Sadik Berisha

Auditor Ligjor

FINCA Kosovë
Pasqyra e pozitës financiare
Më 31 dhjetor 2024

	Shënime	Më 31 dhjetor, 2024 (në EUR)	Më 31 dhjetor, 2023 (në EUR)
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e parashë	6	8,320,066	3,519,559
Huatë ndaj klientëve	7	106,568,440	83,064,362
Parapagimet dhe pasuritë tjera	8	134,251	157,135
Pasuritë e paprekshme	9	281,970	392,686
Prona dhe pajisjet	10	399,588	374,657
Pasuritë me të drejtë përdorimi	11	2,101,462	1,832,549
Gjithsej pasuritë		117,805,777	89,340,948
DETYRIMET			
Huazimet	12	78,850,357	56,163,331
Detyrimet tjera	13	3,355,777	2,620,390
Detyrimet e qirasë	11	2,143,129	1,866,189
Gjithsej detyrimet		84,349,263	60,649,910
Kapitali			
Kapitali i dhuruar	14	4,656,887	4,656,887
Teprica e bartur		28,799,627	24,034,151
Gjithsej kapitali		33,456,514	28,691,038
Gjithsej detyrimet dhe kapitali		117,805,777	89,340,948

Autorizuar për lëshim nga Bordi i drejtorëve i FINCA Kosovë më 25 prill 2025 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Ardian Kastrati
Drejt看 ekzekutiv

Endrit Duraku
Drejt看 financiar

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FINCA Kosovë**Pasqyra e tepricës ose deficitit të fondeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse**

Më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënime	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor, 2024 (në EUR)	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor, 2023 (në EUR)
Të hyrat nga interesi	15	17,664,727	14,319,881
Shpenzimet e interesit	15	(4,019,209)	(2,503,749)
Të hyrat neto nga interesi		13,645,518	11,816,132
Ngarkimi i humbjeve të kredisë nga huatë për klientët	7	(1,129,282)	(951,163)
Të ardhurat neto nga interesi pas ndryshimeve të ngarkimit të kredisë		12,516,236	10,864,969
Të hyra të tjera operative	16	759,704	671,594
Shpenzimet e personelit	17	(4,432,071)	(3,911,152)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	18	(3,503,410)	(3,125,361)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	9,10,11	(650,132)	(589,606)
Të hyrat neto të tjera jo-operative	19	75,149	25,570
Tepricë për vitin		4,765,476	3,936,014
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		4,765,476	3,936,014

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FINCA Kosovë**Pasqyra e ndryshimeve në fonde**

Më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Kapitali i dhuruar (në EUR)	Teprica e bartur (në EUR)	Gjithsej (në EUR)
Gjendja më 1 janar 2023	4,656,887	20,098,137	24,755,024
Teprica neto për vitin	-	3,936,014	3,936,014
Të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	4,656,887	24,034,151	28,691,038
Teprica neto për vitin	-	4,765,476	4,765,476
Të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	4,656,887	28,799,627	33,456,514

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FINCA Kosovë
Pasqyra e rrjedhës së parasë

Më dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënime	2024	2023
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Teprica e vitit		4,765,476	3,936,014
<i>Rregullimet për:</i>			
Zhvierësim dhe amortizim	9,10,11	650,132	589,609
Humbje nga rënia në vlerë e huave	7	1,129,282	951,163
Të hyrat nga interesi	15	(17,664,727)	(14,319,881)
Shpenzimet e interesit	15	4,019,209	2,503,749
Të hyrat neto të tjera jo-operative		-	(357)
Humbja nga transaksionet e këmbimit valutor		135	(13,240)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		(7,100,493)	(6,352,943)
 Huatë ndaj klientëve, net nga rikuperimet	7	(24,410,766)	(19,166,644)
Parapagimet dhe pasuritë tjera		(22,884)	385,778
Detyrimet tjera	13	735,252	373,804
Interesi i pranuar		17,430,446	14,113,466
Interesi i paguar		(3,599,221)	(1,803,260)
Rrjedha neto e parasë (e përdorur në) aktivitetet operative		(16,967,666)	(12,449,799)
 Rrjedha e parasë nga aktiviteti investues			
Blerja e pronës dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	9,10	(224,175)	(322,174)
Paraja neto (e përdorur në) aktivitetet investuese		(224,175)	(322,174)
 Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare			
Kreditë e paguara tek huadhënësit	12	40,625,828	23,500,000
Kreditë e marra nga huadhënësit	12	(18,356,540)	(10,213,266)
Detyrimet ndaj qirasë	11	(276,940)	(271,293)
Rrjedha neto e parasë e gjeneruar nga aktivitetet financiare		21,992,348	13,015,441
 Rritja neto në para dhe ekuivalentë e parasë		4,800,507	243,468
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		3,519,559	3,276,091
 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë më 31 dhjetor	6	8,320,066	3,519,559

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.